

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



ANALIZA E PERFORMANCËS VJETORE 2024

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS



ADRESA: RR. "JORDAN MISJA", GODINA NR.3, TIRANË

www.ndihmajuridike.gov.al
instagram:drejtorianjihmesjuridikefalas

email: dnjf@drejtesia.gov.al
facebook: Drejtoria e Ndhimes Juridike Falas

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



MINISTRIA E DREJTËSISË DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

ANALIZA E PERFORMANCËS VJETORE 2024

Në mbështetje të shkronjës “b” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, u hartua raportimi për vitin 2024.

Ky raport përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga ligji nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë, dokumentat strategjike në të cilat institucioni është i përfshirë, si dhe prioritetet dhe objektivat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për vitin 2025, të ndara respektivisht sipas krerëve.

Botimi i këtij raportimi u mundësua me mbështetjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në kuadër të projektit “Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”, financuar nga bashkëpunimi Austriak për zhvillim (ADC) dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i DNJF-së	4
1.1 <i>Struktura e DNJF-së</i>	4
2 Ndhimja Juridike Parësore	6
2.1 <i>Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore</i>	6
2.1.1 <i>Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas të QSHNJP-ve.</i>	8
2.2 <i>Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit, pranë IAL-ëve.</i>	8
2.2.1 <i>Angazhimi i Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas në kuadër të zhvillimit të trajnimeve për studentët</i>	9
2.2.2 <i>Zhvillimi i praktikave 3- mujore të punës pranë DNJF dhe QSHNJP.</i>	10
2.3 <i>Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse nga Ministri i Drejtësisë.</i>	11
2.4 <i>Të dhënat statistikore për vitin 2024, ndihma juridike parësore.</i>	14
2.5 <i>Një konkluzion i të dhënave statistikore, ndihma juridike parësore, me një qasje krahasuese ndër vite</i>	19
3 Ndhimja juridike dytësore	23
3.1 <i>Procesi i lidhjes së kontratave me avokatët</i>	23
3.2 <i>Trajnimi i avokatëve pjesë e listës</i>	23
3.3 <i>Ecuria e vendimeve për pranimin e ndihmës dytësore.....</i>	24
3.4 <i>Caktimi i Avokatëve</i>	27
3.5 <i>Një konkluzion i të dhënave statistikore, ndihma juridike dytësore, me një qasje krahasuese ndër vite:</i>	28
4 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore dhe dytësore.....	33
4.1 <i>Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore</i>	33
4.1.1 <i>Analizë e raporteve të monitorimit të kryera në QSHNJP</i>	34
4.1.2 <i>Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave</i>	34
4.1.3 <i>Konkluzione dhe Rekomandime nga Monitorimet e QSHNJP</i>	37
4.2 <i>Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.....</i>	38
5 Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike	41
5.1 <i>Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjësuëse</i>	41
5.1.1 <i>Zhvillimi dhe pjesëmarrja e DNJF në aktivitete/ takime</i>	41
5.1.2 <i>Zhvillimi dhe pjesëmarrja e QSHNJP në aktivitete/ takime</i>	49
5.2 <i>Zhvillimi i intervistave televizive në kuadër të edukimit ligjor të publikut.....</i>	88
5.3 <i>Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe vendor si dhe me organizata jofitimprurëse që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.</i>	91
6 Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore	93
7 Kontribute dhe raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike.....	94

8	Raportime ndërkombëtare	95
9.	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse.	96
10	Prokurimet	98
11	Të dhëna buxhetore.....	100
12	Arritjet e DNJF për vitin 2024- Vështrim krahasimor 2021 - 2024	103
13	Plani i Punës së DNJF, 2025.....	113

Lista e Shkurtimeve

- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas - DNJF
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP
- Ministria e Drejtësisë - MD
- Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore – QSHNJP
- Dhoma Vendore e Avokatisë- DHVA
- Kontrolli i Lartë i Shtetit - KLSH
- Organizata Jofitimprurëse - OJF
- Qendra e Botimeve Zyrtare - QBZ
- Bashkimi Evropian - BE
- Departamenti i Administratës Publike - DAP
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike - ASPA
- Agjencia Austriake për Zhvillim – ADA
- Centre for Legal Empowerment- CLE
- Prezenca e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri- OSBE
- Institucione të Arsimit të Lartë- IAL

1. FUNKSIONIMI ME KAPACITET TË PLOTË I DNJF-SË

1.1 STRUKTURA E DNJF-SË

➤ **Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF-së, me qëllim garantimin e vijimësisë së shërbimit të QSHNJP-ve, të hapura me mbështetjen e UNDP/ADC.**

Referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit (Nëntor 2024-Shkurt 2025) nënshkruar midis UNDP dhe MD, MD ndërmerr angazhimin për garantimin e vijimësisë së ofrimit të shërbimit nga ana e 6 (gjashtë) QSHNJP të mbështetura nga UNDP, pas përfundimit të kontratës së grantit.

Aktualisht DNJF administron si pjesë e strukturës së saj buxhetore 14 qendra. Me përfundimin e marrëveshjes me UNDP në Shkurt 2025, me qëllim garantimin e vijimësisë së shërbimeve, është e domosdoshme që 6 QSHNJP e mbështetura nga UNDP të kalojnë me buxhet shteti, duke shkuar në 20 qendra në total.

Si rrjedhojë, lind nevoja për pajisjen me punonjës shtesë për QSHNJP. Në këto kushte, DNJF i është drejtuar MD me shkresën me nr. 695 prot., datë 13.03.2024, nëpërmjet të cilës propozon miratimin e punonjësve shtesë për qendrat. Ky propozim është reflektuar edhe në hartimin e Projekt-Buxhetit Afatmesëm PBA (2025-2027) faza e parë, dërguar MD-së me shkresën me nr. 979 prot., datë 24.04.2024, si dhe në hartimin e Projekt-Buxhetit Afatmesëm PBA (2025-2027) faza e dytë, dërguar MD-së me shkresën me nr. 1878 prot., datë 28.08.2024.


Miratimi i numrit shtesë të punonjësve të QSHNJP kërkon rrjedhimisht edhe ndryshimin e strukturës së DNJF-së. Për këtë arsye me shkresën me nr. 1838 prot., datë 23.08.2024, DNJF ka propozuar pranë MD ndryshimin e strukturës së saj, duke parashikuar një rritje të numrit të punonjësve të QSHNJP (*24 punonjës në total, 16 qendra me nga 1 punonjës dhe 4 qendra me nga 2 punonjës*).

Shtimi i QSHNJP, pjesë e strukturës së institucionit, kërkon rrjedhimisht edhe shtimin e kapaciteteve në drejtëm të monitorimit të cilësisë së shërbimit të ofruar nga ana e këtyre qendrave. Duke marrë në konsideratë rekomandimet e KLSH-së në raportin e auditit me temë: *“Ndihma juridike për individët në nevojë”* DNJF duhet të shqyrtojë mundësinë e riorganizimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimeve dhe garantimit të cilësisë së shërbimit.

Në këto kushte, në propozimin për shtimin e numrit të punonjësve të QSHNJP drejtuar MD, është reflektuar edhe kërkesa për miratimin e 4 (*katër*) punonjësve shtesë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimeve dhe garantimit të cilësisë së shërbimit (*4 punonjës në total, 3 specialistë dhe 1 përgjegjës sektori*).

Propozimi për shtimin e numrit të punonjësve të QSHNJP, garanton vijimësinë e shërbimit të ofruar nga qendrat e hapura me mbështetjen e donatorëve por edhe njëkohësisht rritjen e efektivitetit të monitorimeve dhe garantimin e cilësisë së shërbimit të ofruar nga ana e tyre.

ORGANIGRAMA E PROPOZUAR E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE
FALAS



2 NDIHMA JURIDIKE PARËSORE

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyçe të DNJF-së. Përgjatë kësaj periudhe, DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP, CLE apo OSBE me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

2.1 QENDRAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Bazuar në kompetencën e caktuar në nenin 8, pika gj, DNJF administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, QSHNJP, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

- ❖ *Për vitin 2024, DNJF administron 20 (njëzetë) QSHNJP si vijon: 6 (gjashtë) QSHNJP financohen nga UNDP/ADC përkatësisht në qytetin e Lezhës, Pogradecit, Dibrës, Kukësit, Beratit dhe Elbasanit, kurse 14 (katërmëdhjetë) qendra si: Tirana, Lushnje, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbini, Gjirokastra, Fieri, Vlora dhe Korça (financohen nga buxheti i shtetit), sipas tabelës si vijon:*

Nr.	Qendra	Hapur/Rivitalizuar	Vendndodhja	Mbështetës
1	Tiranë	Korrik 2021	Ministria e Drejtësisë	Buxhet Shteti
2	Durrës	Dhjetor 2020- UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	Buxhet Shteti
3	Fier	Shkurt 2021	Këshilli i Qarkut Fier	Buxhet Shteti
4	Lezhë	Dhjetor 2020	Bashkia Lezhë	UNDP/ADA
5	Lushnje	Shtator 2020	Bashkia Lushnje	Buxhet Shteti
6	Gjirokastrë	Dhjetor 2020	Gjykata e Apelit Gjirokastrë	Buxhet Shteti
7	Shkodër	Shkurt 2021-UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	Buxhet Shteti
8	Pogradec	Tetor 2020	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	UNDP/ADA

9	Vlorë	Mars 2021	Bashkia Vlorë	Buxhet Shteti
10	Dibër	Shkurt 2021	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	UNDP/ADA
11	Elbasan	Korrik 2022	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	UNDP/ADA
12	Berat	Korrik 2022	Bashkia Berat	UNDP/ADA
13	Kukës	Nëntor 2022	Bashkia Kukës	UNDP/ADA
14	Korçë	Dhjetor 2022	Gjykata e Apelit Korçë	Buxhet Shteti
15	Përmet	Korrik 2023	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet	Buxhet Shteti
16	Tropojë	Korrik 2023	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë	Buxhet Shteti
17	Mat	Korrik 2023	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	Buxhet Shteti
18	Pukë	Korrik 2023	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë	Buxhet Shteti
19	Kurbin	Gusht 2023	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin	Buxhet Shteti
20	Kavajë	Gusht 2023	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë	Buxhet Shteti

Përgjatë vitit 2024 është bërë i mundur kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së institucionit të 2 qendrave të hapura me mbështetjen e UNDP në Vlorë dhe Korçë (në kuadër të marrëveshjes mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC)).



2.1.1 KALIMI NËN ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS TË QSHNJP-VE.

Me hyrjen në fuqi të Urdhrit nr. 163, datë 25.03.2024 *"Për kalimin si pjesë e strukturës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, të Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore Vlorë dhe Korçë"*, të Ministrit të Drejtësisë, është miratuar kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së DNJF-së, i QSHNJP në Vlorë dhe Korçë.

➤ *Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastër.*

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit nr.1105/7, datë 09.06.2022 me Bashkinë Gjirokastër, QSHNJP ushtroi veprimtarinë pranë ambienteve të "Pallatit të Sportit", Gjirokastër, por u njoftua nga Bashkia Gjirokastër për lirimin e ambienteve për arsye të rikonstruksionit të ambienteve.

Nëpërmjet shkresës me nr. 508 prot., datë 20.02.2024, me lëndë: "Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të vendosjes në dispozicion të një posti pune pa kundërshpërblim pranë ish Gjykatës së Apelit Gjirokastër" DNJF i është drejtuar kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër në drejtim të gjetjes së ambienteve, pa kundërshpërblim.

Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 208 datë 12.04.2024, *"Mbi ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe menaxhimin e brendshëm të disa institucioneve të varësisë së MD"* përcaktohet se QSHNJP nga data 01.05.2024, ushtron veprimtarinë administrative në zyrën nr. 101, në ambientet e ish-godinës së Gjykatës së Apelit Gjirokastër, me numër pasurie 8/18 ND, ndodhur në zonën kadastrale nr. 8542, volumi 6, faqe 58, në përgjegjësi administrimi të MD-së.

2.2 LIDHJA E MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT ME KLINIKAT E LIGJIT, PRANË IAL-ËVE.

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, *"Klinikë ligjore"* është njësia përbërëse e një IAL, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me DNJF.

Aktualisht DNJF ka lidhur marrëveshje me 13 IAL dhe konkretisht:

1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin *"Marin Barleti"*;
2. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;
3. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar *"Bedër"*;
4. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar *"Wisdom"*;
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin European të Tiranës;
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin *"Aleksandër Moisiu"*, Durrës;

7. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Ismail Qemali*”, Vlorë;
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Qiriazi*”;
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (*Klinika e Ligjit Shkodër*);
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Mesdhetar*”.
11. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Luarasi*”.
12. Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 30 prot., datë 04.02.2022, me Universitetin “*Epoka*”.
13. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Universitetin “*Aleksandër Xhuvani*”, Elbasan.

❖ **Risi për vitin 2024, një klinikë ligjore i shtohet sistemit të Ndhmës Juridike Falas, klinika ligjore pranë universitetit “*Aleksandër Xhuvani*”, duke e rritur në 13 numrin e klinikave ligjore pranë IAL-eve, për vitin 2024.**



2.2.1 ANGAZHIMI I DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË KUADËR TË ZHVILLIMIT TË TRAJNIMEVE PËR STUDENTËT

Referuar nenit 16 të ligjit Nr.111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, është detyrim ligjor i DNJF të bashkëpunojë me klinikat ligjore për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Për vitin 2024, janë trajnuar nga DNJF 91 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Universitetit “Bedër”, “Epoka”, “Luarasi”, “Marlin Barleti”, “Mesdhetari” dhe Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të cilët u pajisën me Vërtetim për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Në këtë trajnim, studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, u informuan mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përftimin e ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese si dhe procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas referuar moduleve të poshtëshënuara:

- Moduli nr. 1 “*Ndihma juridike parësore*”;
- Moduli nr. 2 “*Ndihma juridike dytësore*”;

- Moduli nr. 3 “Legjislacioni specifik për kategoritë e veçanta drejtëpërdrejtë përfituese të ligjit si dhe kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme”;
- Moduli nr. 4 “Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane”.

Gjithashtu, u trajtuan raste praktike të lidhura ngushtësisht me problemet konkrete të institucioneve të administratës, kërkesat për informacion dhe ankesat, arritjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmen.



2.2.2 ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE 3- MUJORE TË PUNËS PRANË DNJF DHE QSHNJP.

Për vitin 2024, kanë zhvilluar praktikat e punës pranë DNJF-së dhe QSHNJP Tiranë, Lezhë, Kukës, Lushnjë, Berat, Durrës, Elbasan dhe Shkodër **97 studentë**, të cilët u pajisën dhe me vërtetimet përkatëse.



2.3 AUTORIZIMI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE NGA MINISTRI I DREJTËSISË.

Ekzistenca e një shoqërie aktive civile është tregues i demokracive funksionale që i japin hapësirë në jetën publike dhe vendimmarrje larmisë së gjerë të mendimeve, shqetësimeve dhe zgjidhjeve të ndryshme. Me anë të ndërthurjes së burimeve të ndryshme publike dhe private për të arritur misionin e tyre, organizatat e shoqërisë civile janë shpesh burim novacioni shoqëror, duke ofruar zgjidhje për çështje me interes publik. Kuadri ligjor ndërkombëtar i kushton një rëndësi thelbësore pjesëmarrjes së barabartë dhe efektive në çështjet politike dhe publike për qeverisjen demokratike. BE i ka kushtuar një rëndësi të veçantë këtij komponenti në kuadër të procesit të integritimit.

Referuar nenit 15, të ligjit 111/2017, OJF-të japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Procedura dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe VKM-së Nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

Akti i autorizimit të OJF-ve nga ana e MD, ka një afat vlefshmërie prej 2 (dy) vitesh. Që prej vitit 2020, OJF-të i janë nënshtruar procedurës së autorizimit 3 (tre) herë rradhazi dhe konkretisht: Tetor 2020-Tetor 2022; Tetor 2022-Tetor 2024; Tetor 2024-Tetor 2026.

Sa i përket procedurës së autorizimit të OJF-ve për vitin 2024, me shkresën me nr. 1676/1 prot., datë 31.07.2024, DNJF i është drejtuar QBZ-së me qëllim shpalljen e thirrjes për autorizimin e organizatave jofitimprurëse në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për periudhën 2024-2026. Thirrja u shpall në faqen zyrtare të QBZ (Nr. 20, viti 2024) dhe mbeti e hapur nga data 30.07.2024 deri më datë 28.08.2024.

Me qëllim kryerjen e një njoftimi sa më gjithëpërfshirës dhe transparent, DNJF me shkresën nr. 314 prot., datë 30.01.2024, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*institucioni përgjegjës për administrimin e regjistrit të organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë*), me qëllim vendosjen në dispozicion të listës së organizatave jofitimprurëse që kanë si pjesë të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimit ligjor falas.

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën me nr. 785/1 prot., datë 06.03.2024, na është vendosur në dispozicion një listë e organizatave jofitimprurëse që kanë si pjesë të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimit ligjor. Organizatat jofitimprurëse janë njoftuar në rrugë shkresore mbi hapjen e thirrjes për autorizim, respektivisht me shkresat me nr. 1715 prot., datë 31.07.2024; dhe nr.1715/1 prot., datë 31.07.2024.

Procedura e dhënies të autorizimeve ka përfunduar në muajin Tetor 2024, përmes lëshimit të Urdhrave të Ministrit të Drejtësisë. Konkretisht, lista e organizatave jofitimprurëse është si vijon:

Nr.	Emërtimi i OJF-së	Selia	Email
1	<i>Forumi i Gruas Elbasan (FGE)</i> Dr. Ekzekutiv: Shpresa Banja.	<i>Elbasan</i>	forumigruaselbasan1991@gmail.com 0692261047
2	<i>Instiuti i Migracionit, Zhvillimit dhe Integritetit (IMZHI);</i> Dr. Ekzekutiv: Enkelejt Avdyli	<i>Tiranë</i>	qendrainmzhi@gmail.com
3	<i>Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)</i> Dr. Ekzekutiv: Aurela Bozo.	<i>Tiranë</i>	avokatore2@yahoo.com 0674130214
4	<i>Qendra Psiko-Sociale Vatra</i> Dr. Ekzekutiv: Brikena Puka.	<i>Vlorë</i>	info@qendravatra.org.al 0693010486
5	<i>Qendra e Gruas Hapa të Lehtë</i> Dr. Ekzekutiv: Denada Shpuza.	<i>Shkodër</i>	qendragruashk@yahoo.com 0674060021
6	<i>Qendra ALTRI</i> Dr. Ekzekutiv: Eda Noçka.	<i>Tiranë</i>	qendra.altri@gmail.com 0692050676
7	<i>Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza</i> Dr. Ekzekutiv: Iris Luarasi.	<i>Tiranë</i>	linjakeshillimit@gmail.com 0693300024
8	<i>Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”</i> Dr. Ekzekutiv: Artë Dyrmishi.	<i>Berat</i>	artadyrmishi@hotmail.com 0695563857
9	<i>Shoqata “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”</i> Dr. Ekzekutiv: Marjana Hereni.	<i>Tiranë</i>	m.hereni@rmsa.al 069777374666
10	<i>Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin</i> Dr. Ekzekutiv: Elona Hoxha.	<i>Tiranë</i>	info@acpd.org.al +355 442253839
11	<i>Qendra “Konsumatori Shqiptar”</i> Dr. Ekzekutiv: Ersida Teliti	<i>Durrës</i>	qendrakonsumatorishqiptar@gmail.com 0693961511
12	<i>Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara</i> Dr. Ekzekutiv: Anjeza Puka	<i>Tiranë</i>	office@qshpli.org . +355 42223880
13	<i>Organizata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”</i>	<i>Tiranë</i>	mmeshi@yahoo.co.uk . 0692088696

	Dr. Ekzekutiv: Marjana Meshi		
14	Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë” TLAS Dr. Ekzekutiv: Rajmonda Bozo	Tiranë	tlas@tlas.al 0692569731

Për vitin 2024, janë autorizuar 14 (*katërmëdhjetë*) organizata jofitimprurëse, me shtrirje në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Berat.



- ❖ **Risi për vitin 2024, propozimi për disa ndryshime në VKM nr. 55/2019, “Për autorizimin e organizatave jofitimprurëse në ofrimin e ndihmës juridike parësore”, në drejtim të lehtësimit të procedurës së autorizimit të organizatave dhe heqjen e afatit 2 vjeçar të aplikimit.**

Konkretisht, qëllimi për ndryshimin e VKM nr. 55/2019, duke marrë në konsideratë problematikat dhe rekomandimet e evidentuara, është lehtësimi i procedurave burokratike në drejtim të procesit të derregullimit. Tashmë është parashikuar që autorizimi të jetë pa afat vlefshmërie dhe kërkesa për autorizim të paraqitet online nëpërmjet platformës qeveritare E-Albania. Sanksionohet një minimizim i dokumentacionit të ngarkohet nga OJF-të duke bërë të mundur administrimin e dokumentacionit kryesisht nga DNJF në ndërveprim me gjykatat (*psh statusi, vërtetim që organizata nuk është në procedura falimenti/likuidimi, etj*). Kjo lehtëson koston financiare dhe kohore për organizatat jofitimprurëse.

Ky projekt-vendim është marrë në konsideratë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe do të përfshihet në Programin Analitik të Projekt-Akteve për vitin 2025.

- ❖ **Pas miratimit të autorizimeve MD, është detyrë e MD/DNJF që brenda 1 muaj nga miratimi i ligjit për buxhetin, të vijojë me shpalljen e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar, procedurë e cila rregullohet me VKM nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, i ndryshuar. Objektivi për MD/DNJF është përfundimi i procedurave të financimit brenda vitit 2025.**

2.4 TË DHËNAT STATISTIKORE PËR VITIN 2024, NDIHMA JURIDIKE PARËSORE.

47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në 100 % të territorit të vendit:

- ✓ **20 (njëzet) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore** në Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Tropojë, Përmet, Puka, Mati, Kavajë, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan.
- ✓ **14 (katërbëdhjetë) organizata jofitimprurëse** të cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër dhe Vlorë të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë
- ✓ **13 (trembëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi me klinikat ligjore** pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë dhe Shkodër.
- ✓ *Platforma ONLINE (ndihma juridike parësore)- juristionline.al.*
- ✓ *Numri i gjelbër pa pagesë: 08001010.*

Nr. total i rasteve të raportuara, nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore: 20 Qendra të Shërbimit, 14 OJF dhe 13 Klinika të Ligjit, për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 6220 raste të raportuara¹.


¹ Rastet e trajtuara në total, së bashku me Platformën Juristi Online dhe Nr. i Gjelbër, për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 7009

Rastet e trajtuara nga Platforma Juristi Online për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 639.

Rastet e trajtuara nga Numri i Gjelbër për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 150

- Rastet e raportuara nga ofruesit e shërbimit për muajt Janar – Dhjetor 2024, paraqitet në mënyrë tabelare dhe grafike, si vijon:


Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Organizatat Jofitimprurëse të autorizuar	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Total
Janar	359	261	0	620
Shkurt	308	266	0	574
Mars	212	288	1	501
Prill	331	231	0	562
Maj	342	247	0	589
Qershor	269	195	1	465
Korrik	305	203	0	508
Gusht	231	117	0	348
Shtator	338	250	0	588
Tetor	395	204	0	599
Nëntor	273	149	0	422
Dhjetor	229	215	0	444
Total	3592	2626	2	6220



➤ Të dhëna statistikore të ndihmës juridike parësore, të kategorizuara sipas:


▪ Gjinisë:

Lloji i ndihmës	Meshkuj	Femra	E Papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2024
<i>Nr. rasteve nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	2280	3922	18	6220
<i>Përqindje</i>	37%	63%	0%	




▪ Sipas natyrës së çështjes:

Lloji i ndihmës	Civile	Penale	Administrative	E Papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2024
<i>Nr. rasteve nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	2737	425	2823	235	6220
<i>Përqindje</i>	44%	7%	45%	4%	



▪ Sipas Kategorive përfituese të përcaktuara në ligj:

Lloji i ndihmës	Kategoritë pa të ardhura dhe pasuri	Kategoritë e veçanta	E papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2024
<i>Nr raste nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	3157	2644	419	6220
<i>Përqindje</i>	51%	42%	7%	



Neni 11 i Ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parashikon në mënyrë shteruese 12 kategori të veçanta, përfitues të ndihmës juridike falas, pavarësisht të ardhurave dhe pasurive që disponojnë. Për vitin 2024, vihet re se kategoritë me numër më të madh përfituesish, vetëm për ndihmën juridike parësore, janë:

Kategoria e veçantë	Nr.i përfituesve - viti 2024
Viktima të dhunës në familje	1136 përfitues
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP	578 përfitues
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	367 përfitues
Pensionistë	162 përfitues
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	130 përfitues
Përfitues të ndihmës ekonomike	103 përfitues
Viktima të mitur	46 përfitues
Statusi i të verbrit	45 përfitues
Viktima të abuzuar seksualisht	27 përfitues

Kategoria e veçantë	Ndihmë Juridike Parësore	Ndihmë Juridike Dytësore	Kategoria Total
Viktima të dhunës në familje	1136	137	1273
Viktima të abuzuar seksualisht	27	1	28
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	130		130
I mitur si kategori e veçantë	46	1	47
Të mitur në konflikt me ligjin	6	1	7
Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore	1	1	2
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor	0		
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP	578	186	764
Statusi i të verbrit	45	49	94
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor	3		3
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor	8		8
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar	1		1
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	367	104	471
Përfitues të ndihmës ekonomike	103		103
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor	0		
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim	6	1	7
Pensionistë	162		162
E papërcaktuar kategoria e veçantë përfituese	25		25
Nr. Total i kategorive të veçanta - Ndihmë Juridike Parësore & Dytësore - 2024	2644	481	2884
Romë/egjiptiane	374	0	374
Të mitur total ²	279	3	282

² Të mitur total nuk përfshin përlogaritjen e nr e viktimave të mitur, apo të mitur në konflikt me ligjin, si kategori e veçantë.

2.5 NJË KONKLUZION I TË DHËNAVE STATISTIKORE, NDIHMA JURIDIKE PARËSORE, ME NJË QASJE KRAHASUESE NDËR VITE


Në zbatim të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është krijuar që prej vitit 2018. Ky informacion konsiston në të dhënat statistikore të numrit të ofruesve të ndihmës juridike parësore, QSHNJP, OJF dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ëve, numrin e përfituesve të ndihmës juridike parësore, si dhe aktivitetet promovuese të DNJF-së, ndër vite.

➤ Ofruesit e ndihmës juridike parësore, viti 2018-2024

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore ofrohet nga:

- punonjësit me trajnim të posaçëm (pranë QSHNJP-ve);*
- organizatat jofitimprurëse të autorizuar;*
- klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Ndër vite, ofruesit e sistemit të ndihmës juridike parësore kanë arritur në rritje. **Nga 25 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore për vitin 2020 (baseline), DNJF në vitin 2024 administron 47 ofrues të shërbimit (tejkalluar në masën 59% objektiv i përcaktuar në Strategjinë për Ndhmën Juridike Falas (2020-2025), me një rritje prej 5% në vit të numrit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore).** Kjo rritje pasqyrohet në formë grafike, si më poshtë:




a) Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Një nga objektivat kryesore të DNJF-së ka qenë hapja e QSHNJP-ëve, si njësi të drejtëpërdrejta të ofrimit të shërbimit për individët në nevojë, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas qarqeve.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, aktualisht, përvec se administron nga 1 QSHNJP në qytetin përfaqësues, kryesor të çdo qarku (12 Qendra: në Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë), administron edhe 8 QSHNJP në ato qytete, gjykatat e të cilave janë mbyllur si pasojë e riorganizimit të

gjykatave, sipas hartës së re gjyqësore (*Mat, Lushnje, Permet, Pogradec, Tropojë, Kurbin, Kavajë dhe Pukë*). Nga 7 QSHNJP funksionale për vitin 2020 (baseline), Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas në vitin 2024 administron 20 QSHNJP.



b) Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara


Referuar nenit 15, të ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, OJF-të japin shërbime të ndihmës juridike parësore, në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Që prej vitit 2020, OJF-të i janë nënshtruar procedurës së autorizimit 3 (tre) herë rradhazi dhe konkretisht: Tetor 2020-Tetor 2022; Tetor 2022-Tetor 2024; Tetor 2024-Tetor 2026. Në vitin 2023 finalizohet për herë të parë financimi 1-vjeçar i Organizatave Jofitimprurëse, të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, ku 2 OJF fitojnë financimin nga buxheti i shtetit.

Për vitin 2024 janë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë 14 OJF për ofrimin e ndihmës juridike parësore, që operojnë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Berat, Shkodër. Një OJF fiton autorizim për herë të parë.



c) Klinikat e Ligjit pranë IAL-eve.


Për vitin 2024 DNJF ka lidhur marrëveshje me 13 Institucione të Arsimit të Lartë. Janë nënshkruar 12 marrëveshje bashkëpunimi me Klinikat Ligjore pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, të cilat operojnë në Tiranë, Vlorë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër. Gjatë vitit 2020 janë lidhur 9 (nëntë) marrëveshje, gjatë vitit 2021 janë lidhur 2 (dy) marrëveshje, gjatë vitit 2022 është lidhur 1 (një) marrëveshje dhe për vitin 2024 është lidhur 1 (një) marrëveshje.



➤ Të dhëna statistikore, mbi numrin e përfituesve të ndihmës juridike parësore, 2019-2024:

- Viti 2019: 23 përfitues
- Viti 2020: 2427 përfitues
- Viti 2021: 5644 përfitues
- Viti 2022: 5861 përfitues
- Viti 2023: 7008 përfitues
- Viti 2024: 6220 përfitues


(Ndihma juridike parësore: të dhëna të përlogaritura vetëm nga ofruesit: Qendrat e Shërbimit, OJF e autorizuara dhe Klinikat e Ligjit. Në këto shifra nuk përfshihen përfitues nga Platforma Juristi Online, apo Nr.i Gjellbër 0800 1010).



Përgjatë 2019-2024, kanë përfituar ndihmë juridike parësore 27 183 qytetarë.

➤ **Aktivite promovuese ndër vite.**

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyçe të DNJF-së. Përgjatë kësaj periudhe, DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP, CLE apo OSBE me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.



3 NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

Ndihma juridike dytësore është një nga format më thelbësore të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. Referuar kuadrit ligjor për ndihmën juridike, përveç përfaqësimit me avokat falas, tashmë qytetarët në nevojë dhe kategoritë vulnerabël kanë mundësi të përfitojnë edhe përjashtimin nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Nisur dhe nga natyra e çështjeve të ndihmës juridike, karakteri sensitiv që ato kanë, përfaqësimi me avokat falas dhe ndjekja e procesit në gjykatë është i një rëndësie thelbësore për rivendosjen në vend të të drejtave për kërkuesit e shërbimit të ndihmës juridike falas.

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të ligjit Nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*.

3.1 PROCESI I LIDHJES SË KONTRATAVE ME AVOKATËT

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në shkronjën “k”, të nenit 8, të Ligjit Nr. 111/2017, DNJF lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Në muajin Janar 2024, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative, për vitin 2024.

Gjatë kësaj procedure u respektua *“Parimi i Rotacionit”*, si dhe të gjitha rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Përbashkët Nr.17, datë 05.08.2020, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, duke garantuar kështu një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pas miratimit të listës së avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, DNJF vijoi me procesin e lidhjes së kontratave me avokatët e miratuar nga DHASH për vitin 2024.

Nga 177 avokatë që nënshkruan kontratë për ofrimin e shërbimit për ndihmën juridike dytësore, aktualisht këtë shërbim e ofrojnë 166 avokatë për vitin 2024, pasi 11 avokatë janë tërhequr në mënyrë të njëanshme për shkaqe ligjore.

3.2 TRAJNIMI I AVOKATËVE PJESË E LISTËS

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve, ndërveprimit të DNJF-së me Dhomat Vendore të

Avokatisë, si dhe të shkëmbimit të konsideratave, janë zhvilluar trajnime dedikuar ndihmës juridike dytësore.


Referuar nenit 9, shkronja “d”, e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku parashikohet se: “Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me DNJF”, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë ka organizuar trajnime për ofruesit e ndihmës juridike dytësore, ku janë diskutuar tema mbi kuadrin ligjor të përgjithshëm mbi ndihmën juridike, aspektet e dala nga zbatimi në praktikë i ligjit. Trajnimet i’u dedikuan temave të posaçme, të lidhura me kategoritë e veçanta përfituese të ligjit.

3.3 ECURIA E VENDIMEVE PËR PRANIMIN E NDIHMËS DYTËSORE

Nga vendimet gjyqësore me objekt kërkesën për ndihmë juridike dytësore falas, të administruara nga DNJF për vitin 2024, në total rezultojnë **904** vendime gjyqësore. Këto vendime mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore të detajuara në formë tabelare janë si vijon:

Vendime gjyqësore me Objekt Kërkesë për Ndihmë Juridike Dytësore JANAR –DHJETOR 2024										
Lloji i kërkesës	Kërkesa për ndihmë Juridike Dytësore			Përfshirje nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore			Kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe përfshirje nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore			Vendime Total
Lloji i vendimit gjyqësor	Pranim	Rrëzim	Pushim/ Kthim aktesh/ Çështje në gjykim/ Mos-kompetencë	Pranim	Rrëzim	Pushim/ Kthim aktesh/ Çështje në gjykim/ Mos-kompetencë	Pranim	Rrëzim	Pushim/ Kthim aktesh/ Çështje në gjykim/ Mos-kompetencë	
Total	64	1	3	150	5	2	626	38	15	904
	68			157			679			



Në ecurinë përgjatë muajve, mesatarja aritmetike e kërkesave të pranuar për ndihmë juridike dytësore juridike është përafërsisht **75** kërkesa në muaj. Muaji me numrin më lartë të kërkesave është muaji Tetor, me **111** vendime dhe muaji me numrin më të ulët të kërkesave është muaji Gusht me **37** vendime.




➤ **Të dhëna statistikore të ndihmës juridike dytësore, të paraqitura në mënyrë grafike sipas:**

- **Kategorisë përfituese**
- **Gjinisë**


Përsa i përket kategorive të personave kërkuar të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se **46% e përfituesve janë në pamundësi financiare**, si mungesë të ardhurash dhe pasurie, në **53% përfshihen kategoritë e veçanta ligjore** si viktimat e dhunës, përfitues të skemave sociale, etj, ndërsa **1%** e tyre janë kategori e papërcaktuar. Përsa i përket gjinisë, **61%** e kërkuarve rezultojnë gra dhe **39%** rezultojnë burra.



Vendimet e gjykatave për Kërkesat për ndihmë juridike të garantuar sipas natyrës së çështjes 2024



Sipas objektit të çështjeve gjyqësore që qytetarët kanë kërkuar ndihmë juridike dytësore, evidentohet që kryesisht që janë çështje të karakterit civil. Nga totali i kërkesave për ndihmë juridike prej **904**, prej tyre **723** janë civile, ku më kryesoret janë zgjidhje martesë, njohje e viteve të punës, përfitim pensioni dhe konflikte pronësie. Ndërsa kategoritë e tjera **59** janë penale, **120** janë çështje administrative dhe në **2** vendime nuk evidentohet lloji i çështjes.




Përsa i përket pranimit të kërkesave të qytetarëve nga vendimet e gjykatave, evidentohet një marzh shumë i ulët i refuzimit/ kthimit të akteve/ pushim apo moskompetencë. Nga totali i kërkesave, në **57** vendime gjykatat janë shprehur për refuzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore falas.

Referuar detyrimeve dhe tagrave ligjore, Drejtoria e Ndhmës juridike Falas përsa i përket vendimeve për pranim të dhëna nga gjykatat, ka kryer ankime dhe kërkesa për ndreqje gabimesh. Përsa i përket ankimeve, DNJF ka ankimuar ose ka bërë kërkesë për ndreqje gabimi për rreth **5% të totalit**. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave kanë ardhur për mangësi

formale në vendimmarrjen e gjykatave, por edhe një pjesë zënë raste ku DNJF ka pretenduar një vendimmarrje jo të saktë nga gjykatat. Konkretisht, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit në **12** raste, si dhe ka hartuar **21** kërkesa për ndreqje gabimi.

Përsa i përket llojit të ndihmës juridike dytësore falas të kërkuar, nga **904** vendime në total, **68** prej tyre janë për kërkesa për të përfituar avokat, **157** për të përfituar mbulim të shpenzimeve gjyqësore dhe **679** janë kërkesa për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore, nga të cilat janë rrëzuar **44** kërkesa dhe **13** janë kthim aktesh/moskompetencë ose pushim çështje.



3.4 CAKTIMI I AVOKATËVE

Nëse analizojmë tërë vendimmarrjen e gjykatave, të përshkruar më sipër, konkretisht, rezulton se Dhoma Vendore të Avokatisë do të duhej të kishin komunikuar vendimmarrjen për caktim të **709 avokatëve**. Ky numër rezulton nga shumatorja e kërkesave për të përfituar avokat, dhe kërkesave për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore. Prej këtij totali, zbritet numri i vendimeve të marra për refuzim të kërkesës nga gjykatat.

Nga analiza e të dhënave rezulton se, Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës ka përcjellë numrin më të lartë të vendimeve për caktimin e avokatëve për **57** raste. Ajo ndiqet nga Dhoma Vendore

Gjirokastër për **47** raste dhe Dhoma Vendore Berat për **18** raste. Në total rezulton se nga Dhomat Vendore janë përcjellë **150** vendime për caktim avokatësh, të cilat i janë komunikuar DNJF-së përgjatë vitit 2024.

Përcjellja e vendimeve për caktim avokati për vitin 2024		
Dhomat Vendore të Avokatisë		Nr. i vendimeve
1	Dhoma vendore e Avokatisë Durrës	57
2	Dhoma vendore e Avokatisë Berat	18
3	Dhoma vendore e Avokatisë Lezhë	1
4	Dhoma vendore e Avokatisë Gjirokastër	47
5	Dhoma vendore e Avokatisë Dibër	12
6	Dhoma vendore e Avokatisë Vlorë	15
Total		150

Sipas këtyre shifrave, rezulton se për më shumë se **2/3 të vendimeve gjyqësore** që kanë pranuar kërkesën e qytetarëve për avokatë, Dhomat Vendore të Avokatisë nuk kanë komunikuar vendimin e caktimit të avokatit. Në këto rrethana, ndër të tjera, bëhet e pamundur vlerësimi nëse Dhomat kanë respektuar parimin e rotacionit në vendimmarrjen e tyre.


3.5 NJË KONKLUZION I TË DHËNAVE STATISTIKORE, NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE, ME NJË QASJE KRAHASUESE NDËR VITE:

I. Nr. i vendimeve gjyqësore, ndër vite, me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore.

Nga analiza e të dhënave, në ecurinë përgjatë viteve 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 konstatohet ky numër kërkesash për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Më konkretisht:

- Në vitin 2019, janë marrë **44** vendime nga gjykatat mbi kërkesat për ndihmë juridike të garantuar nga shteti;
- Në vitin 2020, janë marrë **181** vendime nga gjykatat mbi kërkesat për ndihmë juridike të garantuar nga shteti;
- Në vitin 2021, janë **849** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar nga shteti;
- Në vitin 2022, janë **1030** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar nga shteti;
- Në vitin 2023, janë marrë **773** vendime nga gjykatat mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore, dhe


- Në vitin 2024, janë marrë **904** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike dytësore.





II. Nr. i vendimeve gjyqësore, ndër vite, sipas natyrës së çështjes.


Përsa i përket raportit të natyrës së çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar ndihmë juridike falas, në analizë disa vjeçare shihet ruajtja e plotë e raportit. Çështjet civile shkojnë deri më 80% të totalit të çështjeve për të cilat kërkohet ndihmë juridike falas.

- Për vitin 2019, nga **44** vendime, **38** rezultojnë çështje civile, **6** penale dhe **0** administrative.
- Për vitin 2020, nga **181** vendime, **154** rezultojnë çështje civile, **13** penale dhe **14** administrative;
- Për vitin 2021 nga **849** vendime, **727** rezultojnë çështje civile, **61** penale dhe **57** administrative, 4 çështje ku nuk është përcaktuar natyra;
- Për vitin 2022 nga **1030** vendime, **691** rezultojnë çështje civile, **70** penale dhe **269** administrative;
- Për vitin 2023 nga **773** vendime, **647** rezultojnë çështje civile, **50** penale, **71** administrative dhe **5** vendime të papërcaktuara;
- Për vitin 2024 nga **904** vendime, **723** rezultojnë çështje civile, **59** penale, **120** administrative dhe **2** çështje nuk është përcaktuar natyra.



Natyrë e çështjeve për të cilat është dhënë ndihmë juridike detyësore 2019- 2024					
Viti	Total	Civile	Penale	Administrative	Papërcaktuar
Viti 2019	44	38	6	0	0
Viti 2020	181	154	13	14	0
Viti 2021	849	727	61	57	4
Viti 2022	1030	691	70	269	0
Viti 2023	773	647	50	71	5
Viti 2024	904	723	59	120	2
Vendime gjyqësore total	3781	2980	259	531	11






III. Për këtë periudhë, nga administrimi i vendimeve gjyqësore për përfitimin e ndihmës juridike dytësore janë të mbartuara **2,228 vendime** të cilat mund të konkludojnë me pagesë ose jo sipas akteve ligjore dhe raporteve të vlerësimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. Në konsideratë duhet të mbahet fakti që shumë çështje të viteve paraardhëse janë në shqyrtim nga gjykatat. ***Për këtë arsye numri i vendimeve të likujduara ka qenë në rritje dhe pritet të jetë në rritje nga viti në vit.*** Gjithashtu, si rrjedhojë e riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në vitin 2023 ka hapur në disa qytete Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve. Duke e parë në një qasje krahasuese për periudhën 2018-2024 eidentojmë se trendi i kërkesave për ndihmë juridike dytësore është në rritje.

Të dhëna statistikore mbi likujdimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të çështjeve në themel 2024 (të përcjella për likujdim nga avokatët dhe ekspertët)			
Vendime gjyqësore të likujduara nga DNJF	<i>Nr. i vendimeve gjyqësore të paguara (avokatë)</i>	217	391
	<i>Nr. i vendimeve gjyqësore të paguara (ekspertë)</i>	173	
	<i>Shpenzime gjyqësore</i>	1	
Numri i dosjeve total të refuzuara për ekzekutim pagese			25


Likudimi i Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë, 2024

Nr. i dosjeve te refuzuara për ekzekutim pagese
6%



Vendime gjyqësore te likujduara
94%

Totali i vendimeve gjyqësore me objekt "Kërkesë për ndihmë juridike dytësore" 2019-2024



TOTAL NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE 2019-2024 (3 781 vendime gjyqësore).

4 MONITORIMI I CILËSISË SË OFRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE DHE DYTËSORE

4.1 MONITORIMI I CILËSISË SË OFRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE

Referuar Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në nenin 8 të tij, përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas: “Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, të afuara nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët”.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Për të përmbushur qëllimet e përcaktuara në ligj, Sektori i Monitorimit të Ofruesve të Ndihmës Juridike Parësore dhe Dytësore në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore, pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas që ka përgjegjësinë e kryerjes së monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme në funksion të vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas i cili siguron akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; mirëorganizimi, mirëadministrimi dhe mirëfunksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike si dhe garantimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive janë disa nga qëllimet kryesore të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Këto qëllime shërbejnë si udhëzues të mënyrës si kryhet monitorimi i cilësisë së shërbimit, procesi i cili detajohet në Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Në përmbushje të shkronjës “I” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku përcaktohet se: “Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore”, DNJF ka hartuar kalendarin e mbikëqyrjes për vitin 2024, në të cilin ka detajuar të gjitha monitorimet që do të kryhen përgjatë këtij viti.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore ka vijuar me kryerjen e monitorimeve të të gjitha Qendrave, si dhe me monitorimin fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve, ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

4.1.1 ANALIZË E RAPORTEVE TË MONITORIMIT TË KRYERA NË QSHNJP

Referuar parashikimeve të metodologjisë së miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga qendrat bazohet në monitorimet 3 (tre)-mujore të kryera si dhe raportet mujore narrative të përcjella nga ana e punonjësve të Qendrave. Për çdo raport mujor të përcjellë analizohen të dhënat si dhe orientimi ligjor/ zgjidhja e rasteve të trajtuara. Gjithashtu, raportet synojnë të adresojnë problematika dhe rekomandime nga ana e punonjësve të qendrave në funksion të përmirësimit të ecurisë së veprimtarisë dhe ofrimit të shërbimit nga ana e tyre.

Nga monitorimet e kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, ka rezultuar se:

- *Lidhur me mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr.111/2017:*

- Gjithashtu edhe për zërin “*Blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar*”, institucioni ynë nuk ka patur raste të udhëtimit jashtë vendit.

Theksojmë se janë përmbushur të gjitha nevojat e institucionit duke përdorur fondet me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet (**në total 86%**).

11 TË DHËNA BUXHETORE

Detajimi i buxhetit për vitin 2024 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe është realizuar duke mbajtur parasysh objektivat, qëllimin e synuar dhe përfituesit.

DNJF, për vitin 2024, ka patur si qëllim të saj ofrimin e ndihmës juridike falas për individët që plotësojnë kushtet, si edhe zbatimin dhe monitorimin e cilësisë së dhënies së ndihmës juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për realizimin e këtij qëllimi janë përcaktuar objektivat e mëposhtme:

1. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike.
2. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për gratë dhe vajzat, pjesë e kategorisë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike.

Tabela e mëposhtme paraqet fondet e akorduara nga buxheti i shtetit dhe donatorëve dhe realizimin e tyre në vlerë dhe përqindje.

Art.	Emërtimi	Plani i vitit 2024 (në 000 lekë)	Realizimi viti 2024 (në 000 lekë)	Realizimi në përqindje i buxhetit
600	Paga	42 900	39 050	91%
601	Sigurime Shoqërore	7 000	6.422	92%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	21 526	20 541	95%
604	Transf korrente të brendshme për OJF-të	400	396	99%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	124	119	96%
231	Kapitale te trupëzuara	340	331	97%
Shpenzime Korrente		72 290	66 859	92%
	Të ardhura nga grantet për paga	12 644	12 500	99%
	Të ardhura nga grantet për mallra dhe shërbime të tjera	370	368	99%
Shpenzime nga të ardhura jashtë limiti		13 014	12 868	99%
Totali (korrente + kapitale + Shp nga të ardhura jashtë limiti)		85 304	79 727	93,5%

Duke i'u referuar shifrave për vitin 2024, vihet re një realizim në vlerë prej 66.859.221 lekë, të shpenzimeve të fondeve të financuara nga buxheti i shtetit dhe 12.868.553 lekë realizuar nga fondet e dhëna në formë granti, për mbulimin e shërbimit juridik parësor, për kategoritë përfituese, sipas ligjit për ndihmën juridike në qendrat e miratuara nga MD (*gjithsej 6 Qendra me financim nga UNDP*).

Me financim nga buxheti i shtetit janë miratuar dhe funksionojnë **14 Qendra (Lushnje, Shkodër, Durrës, Tiranë, Gjirokastrë, Fier, Përmet, Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë, Korçë dhe Vlorë).**

1. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore:

Fondet e çelura nga buxheti i shtetit në vlerën totale 49.900.000 lekë (42.900.000 lekë paga dhe 7.000.000 lekë sigurime shoqërore) nga të cilat realizuar 45.471.920 lekë ose e shprehur në përqindje në masën 91%. Realizimi i këtij buxheti i përket fondit të pagave dhe sigurimeve për 34 punonjës nga 39 të miratuar në strukturën organizative të organizimit dhe funksionimit të DNJF-së.

2. Fondi i shpenzimeve për vendimet gjyqësore:


Gjatë vitit 2024 në total janë shlyer detyrimet financiare me objekt “Ndhmën juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifatat dhe shpenzimet” për 391 vendime gjyqësore, me një kosto prej 14.243.120 lekë.

3. Fondi për shpenzimet për funksionimin e veprimtarisë së institucionit është realizuar në vlerën 6.297.942 lekë. Gjithsej fondi për llogarinë ekonomike 602 (shpenzime operative) është realizuar në masën 95%.

4. Shpenzimet kapitale:

Për vitin 2024 Drejtoria e Ndhmës Juridike ka patur buxhet të çelur për investime në vlerën 340.000 lekë, prej të cilave janë realizuar 330.960 lekë (97%).

➤ Realizimi i fondeve buxhetore sipas grafikut:




Pjesë e buxhetit të vitit 2024 janë edhe fondet e akorduara nga organizata ndërkombëtare UNDP për mbulimin e shërbimit juridik parësor për kategoritë përfituese, sipas ligjit për ndihmën juridike në Qendrat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë (gjithsej 6 Qendra me financim nga UNDP). Fondet e akorduara gjatë këtij viti janë në vlerën 13.014.068 lekë, me fokus pagesën

e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 6 Qendra të Shërbimit të Ofrimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Ky fond është realizuar në masën 99% në vitin 2024 dhe fondet e mbetura janë mbartur për përdorim në vitin 2025 në koherencë të zbatimit të akt-marrëveshjeve dhe kontratës me donatorin.

Më poshtë realizimi në formë grafiku i fondeve të akorduar nga donator.

➤ **Realizimi i fondeve nga organizatat në formën e granteve sipas grafikut:**



**12 ARRITJET E DNJF PËR VITIN 2024- VËSHTRIM
KRAHASIMOR 2021 - 2024**

Nr.	<i>Arritjet për çdo objektiv</i>	<i>Viti 2021</i>	<i>Viti 2022</i>	<i>Viti 2023</i>	<i>Viti 2024</i>
1	Numri i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore	33 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore <i>(10 Qendra, 12 OJF; 11 Klinika Ligji pranë Universiteteve)</i>	41 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore <i>(14 Qendra, 15 OJF; 12 Klinika Ligji pranë Universiteteve)</i>	47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore <i>(20 Qendra, 15 OJF; 12 Klinika Ligji pranë Universiteteve)</i>	47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore <i>(20 Qendra, 14 OJF; 13 Klinika Ligji pranë Universiteteve)</i>
2	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga qendrat të shërbimit të ndihmës juridike parësore	10 QSHNJP <i>(Tiranë, Durrës, Lushnje, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër dhe Dibër)</i> 2 Qendra me buxhet shteti në Tiranë dhe Lushnje 8 Qendra me mbështetjen e PNUD (Për vitin 2021 janë hapur 3 qendrat e reja në Vlorë, Dibër dhe Fier)	14 QSHNJP <i>(Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës dhe Korçë)</i> 4 Qendra me buxhet shteti. Kaluar qendra Shkodër dhe Durrës me buxhet shteti. <i>(Tiranë, Lushnje, Shkodër dhe Durrës)</i> 10 Qendra me mbështetjen e PNUD (Për vitin 2022 janë hapur 4 qendrat e reja në Berat, Elbasan, Korçë dhe Kukës) Në vijim të mbylljes së sporteve të ADISA, më dt. 16.05.2022, Drejtori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me	20 (njëzetë) QSHNJP si vijon: 8 (tetë) QSHNJP financohen nga UNDP/ADC në qytetin e Lezhës, Pogradecit, Vlorës, Dibrës, Kukësit, Korçës, Beratit dhe Elbasanit, kurse 12 (dymbëdhjetë) qendra si: Tirana, Lushnja, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbini, Gjirokastra, Fieri, Vlorë dhe Korça (financohen nga buxheti i shtetit). Përgjatë vitit 2023 është bërë i mundur kalimi nën administrim	20 (njëzetë) QSHNJP si vijon: 6 (gjashtë) QSHNJP financohen nga UNDP/ADC në qytetin e Lezhës, Pogradecit, Dibrës, Kukësit, Beratit dhe Elbasanit, kurse 14 (katërmëdhjetë) qendra si: Tirana, Lushnja, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbini, Gjirokastra, Fieri, Vlorë dhe Korça (financohen nga buxheti i shtetit). Përgjatë vitit 2024 është bërë i mundur kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së institucionit të 2 qendrave hapura me mbështetjen e UNDP në Vlorë dhe Korçë (në kuadër të

			<p>PNUD, zhilloi një takim me Kryetaren e Këshillit të Qarkut Fier gjatë të cilës u dakordësua Vendosja në dispozicion e (zyrës) në katin e 1 (parë) të Këshillit të Qarkut Fier. Qendra Fier ushtron funksionin pranë Këshillit të Qarkut Fier që prej muajit Shtator 2022.</p> <p>U mundësua lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bashkinë Gjirokastrë me nr.1105/7 prot., datë 09.06.2022, “Për vendosjen në dispozicion të një ambienti pa kundërshpërblim në godinën e Pallatit të Sportit Gjirokastrë (godinë nën administrimin e Bashkisë Gjirokastrë).</p> <p>Qendra Gjirokastrë ushtron funksionin pranë Pallatit të Sportit Gjirokastrë që prej muajit Korrik 2022.</p>	<p><i>si pjesë e strukturës së institucionit të 2 qendrave hapura me mbështetjen e UNDP në Fier dhe Gjirokastrë (në kuadër të marrëveshjes mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADA)</i></p>	
3	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	11 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë <i>Universitetit Marin Barleti dhe Universitetit Luarasi</i>	12 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë <i>Universitetit Epoka</i>	12 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Përgjatë vitit 2023, pas marrjes dijeni mbi nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit “Aleksandër	13 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve <i>Në Dhjetor 2024 lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.</i>

				<p>Xhuvani” dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) në Shqipëri, mbi themelimin e Klinikës së Ligjit, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dërgoi shkresën me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim, përmes së cilës shprehu interesin mbi mundësinë e bashkëpunimit, përmes nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi me universitetin “Aleksandër Xhuvani”.</p>	
4	<p>Ofrimi i ndihmës juridike falas nga organizatat jofitimprurëse</p>	<p>12 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2020 (autorizim 2 vjeçar sipas VKM nr. 55/2019).</p>	<p>15 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2022 (3 organizata më shumë se në autorizimi Shtator 2020 të specializuara në fushën e viktimave të dhunës në familje, të miturve, refugjatëve etj.);</p>	<p>15 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2022.</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bazë të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe VKM-së Nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë</p>	<p>14 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë për periudhën Tetor 2024-Tetor 2026.</p> <p><i>Organizata IMZHI fiton autorizim për herë të parë.</i></p>

				<p>financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF Nr. 37, datë 06.04.2021, “Për miratimin e dokumentave tip të aplikimit nga organizat jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit”, përfundoi me sukses procedurën e financimit të 2 organizatave jofitimprurëse të cilat tashmë do të ofrojnë shërbime ligjore të financuara nga buxheti i shtetit.</p> <p>Pas një procedure konkurruese u shpallën fituese dy prej tyre, organizata “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza” dhe “Qendra Psiko-Sociale Vatra”.</p> <p>Nënshkruar kontrata me nr. 563/4 prot. datë 27.03.2023 me organizatën “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”;</p> <p>Nënshkruar kontrata me nr. 559/4 prot. datë 27.03.2023 me organizatën</p>
--	--	--	--	--

				“Qendra Psiko-Sociale Vatra”.	
5	Ofrimi i ndihmës juridike dytësore nga avokatët	124 avokatë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021.	157 avokatë aktivë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2022.	160 avokatë aktivë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2023.	177 avokatë aktivë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2024.
6	Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i 10 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnje, Gjirokastër, Fier) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore;	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i 12 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnje, Gjirokastër, Fier, Berat, Elbasan) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore; Në proces: Zhvillimi i monitorimit fillestar për Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës dhe Korçë.	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i 20 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan, Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Tropojë, Përmet, Pukë, Mat, Kavajë, Kurbin, Gjirokastër dhe Fier) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i 20 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan, Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Tropojë, Përmet, Pukë, Mat, Kavajë, Kurbin, Gjirokastër dhe Fier) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore
7	Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucione	Zhvilluar 125 takime/aktivitete ndërgjegjësuese të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura	Zhvilluar 286 takime/aktivitete ndërgjegjësuese të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve të pavarura për vitin 2022. Zhvilluar 1 intervistë në radio e Drejtorit të	Zhvilluar 334 takime/aktivitete ndërgjegjësuese të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura për vitin 2023.	Zhvilluar 643 takime/aktivitete ndërgjegjësuese të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura për vitin 2024. Janë zhvilluar 4 intervista nga Drejtori i

	ve të pavarura	Zhvilluar 5 intervista televizive në televizionet lokale nga QSHNJP.	Përgjithshëm të DNJF-së. Zhvilluar 10 intervista televizive në televizionet lokale nga QSHNJP.	Janë zhvilluar 5 intervista nga Drejtori i Përgjithshëm, i DNJF-së. Zhvilluar 16 intervista televizive në televizionet lokale nga QSHNJP.	Përgjithshëm, i DNJF-së. Zhvilluar 24 intervista televizive në televizionet lokale nga QSHNJP.
8	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse	<p>Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</p> <p>UNDP/ADA (mbështetja për QSHNJP);</p> <p>OSFA/CLE (mbështetja për angazhimin e paralogjorëve për zhvillimin e fushatave informuese në terren);</p> <p>OSCE (mbështetja për zhvillimin e konferencës studentore: “Ndihma juridike e garantuar nga Shteti”);</p> <p>Euralius (Publikimi i Manualit të Ligjit nr.111/2017, dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij).</p>	<p>Vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</p> <p>UNDP/ADA (mbështetja për Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore);</p> <p>OSFA/CLE (mbështetja për angazhimin e paralogjorëve për zhvillimin e fushatave informuese në terren);</p> <p>Caritas Shqiptar (mbështetja për zhvillimin e trajnimit të punonjësve që Qendrave);</p> <p>Expertise France Group ATD (Barazia gjinore në aksesin në mundësitë ekonomike).</p> <p>Pjesëmarrje e DNJF në kuadër të zbatimit të projektit JUSTAL “Asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA II),</p>	<p>Vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</p> <p>UNDP/ADA (Mbështetja për QSHNJP);</p> <p>Expertise France Group ATD (Mbështetja e Expertise France në drejtim të kryerjes së një vizite studimore, shkëmbimi eksperiencash në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.)</p> <p>Mbështetja e së në kuadër të zhvillimit të trajnimit me punonjësit me trajnim të posaçëm qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, mbi mënyrën e komunikimit/pritjes së qytetarëve</p>	<p>Vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</p> <p>UNDP/ADA (Mbështetja për QSHNJP);</p> <p>Expertise France Group ATD (Mbështetja e Expertise France në drejtim të kryerjes së një vizite studimore, shkëmbimi eksperiencash në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.)</p> <p>Mbështetja e së në kuadër të zhvillimit të trajnimit me trajnim të posaçëm qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, mbi mënyrën e komunikimit/pritjes së qytetarëve</p>

			për periudhën kohore 15 Qershor 2022- 14 Qershor 2024.	pjesë e kategorisë së veçantë, referuar nenit 11 të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.	nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Organizata Centre for Legal Empowerment (CLE) vijon bashkëpunimin me DNJF sa i përket funksionimit të platformës juristonline.al (platformë ku cdo qytetar merr përgjigje mbi pyetjen/kërkesën për këshillim ligjor falas <i>Risi për këtë vit mund të evidentojmë bashkëpunimin me organizatën ANAD në drejtim të ofrimit të seancave informuese në gjuhën e shënjave për kategorinë e personave që nuk dëgjojnë</i>
9	Nënshkrim i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të nivel qendror, vendor institucione të pavarura dhe gjykatat, në kuadër të referimit të rasteve dhe	Lidhur 9 marrëveshje bashkëpunimi (me Organizatën Drejtësi Sociale; Shoqatën “Refleksione”; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër; Shoqatën e Invalidëve të Punës; Shoqatën “Shqipëria”, Vlorë; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Patos; Shoqatën	Lidhur 17 marrëveshje bashkëpunimi (me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Bashkinë Berat; Bashkinë Gjirokastrë; Bashkinë Kukës; Bashkinë Korçë; Caritasin Shqiptar; Universitetin Epoka; Këshillin e Qarkut Fier; Gjykatën e Rr. Gj. Elbasan; Gjykatën e Rr. Gj.Durrës; Gjykatën e Rr. Gj.Shkodër; Drejtorinë e Kujdesit	Lidhur 11 marrëveshje bashkëpunimi (me organizatën Centre for Legal Empowerment (CLE); Qendrën “Shërbimi Ligjor Falas”, Tiranë (TLAS); Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN); Bashkinë Përmet; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; Gjykatën e Shkallës së Parë të	Lidhur 15 (pesëmbëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi: (me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Prezenca në Shqipëri; me bashkinë Sarandë; me bashkinë Pustec; me bashkinë Mirditë; me bashkinë Belsh; me bashkinë Peqin; me bashkinë Mallakastër; me bashkinë Krujë; me

	ndërgjegjësimit	“Shtëpi Shprese”; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Berat; Organizatën Jofitimprurëse MDG Berat).	Social Bashkia Lezhë; Organizatën “Vatra”; ISSH Gjirokastër; Qendrën Evropiane; Qendrën për Fuqizimin Ligjor; Fondacionin “Joscelyn”);	Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër;	bashkinë Libohovë; me bashkinë Has; me bashkinë Kuçovë; me bashkinë Klos; me bashkinë Bulqizë; me bashkinë Vorë; me bashkinë Roskovec).
10	Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore	Përfunduar trajnimi i detyrueshëm të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore	Zhvillimi i trajnimeve për 234 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit si dhe zhvillimi praktikave pranë DNJF, Qendrës Tiranë, Vlorë dhe Shkodër për 37 studentë. Përfunduar trajnimi i detyrueshëm i 14 ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore të cilët nuk i ishin nënshtruar trajnimit në vitin 2021.	Për vitin 2023, janë trajnuar nga DNJF 34 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të cilët u pajisën me Vërtetim për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Për vitin 2023, kanë zhvilluar praktikat e punës pranë DNJF dhe QSHNJP Tiranë, Elbasan dhe Shkodër 34 studentë, të cilët u pajisën dhe me vërtetimet përkatëse.	Për vitin 2024, janë trajnuar nga DNJF 91 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të cilët u pajisën me Vërtetim për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Për vitin 2024, kanë zhvilluar praktikat e punës pranë DNJF dhe QSHNJP Tiranë, Lezhë, Kukës, Lushnjë, Berat, Durrës, Elbasan dhe Shkodër 94 studentë, të cilët u pajisën dhe me vërtetimet përkatëse.

11	Raste të trajtuara, ndihma juridike parësore	8153 raste të trajtuara nga QSHNJP, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristonline dhe numri i gjelbër 08001010.	7616 raste të trajtuara nga QSHNJP, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristonline dhe numri i gjelbër 08001010.	7008 raste të raportuara ³ Nga QSHNJP, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristonline dhe numri i gjelbër 08001010.	6220 raste të raportuara ⁴ Nga QSHNJP, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve. Nr. total duke përfshirë edhe platformën juristonline dhe numri i gjelbër 08001010 është 7009 përfitues.
12	Raste të trajtuara, ndihma juridike dytësore	841 vendime me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.	1030 vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.	773 vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.	904 vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.
13	Realizimi Buxhetor: Fonde Buxhetore të akorduara: Fonde Jobuxhetore nga organizata:	29.702.483 lekë 66.500.000 lekë 15.253.893 lekë	36.837.614 lekë 47.200.000 lekë 20.486.157 lekë	51.232.258 lekë 66.550.000 lekë 18.581.073 lekë	66.859.221 lekë 72.290.000 lekë 12.868.553 lekë
14	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara nga DNJF	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore gjatë vitit 2021 është 143 vendime. Ndihmë juridike dytësore (pagesa	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore për periudhën 2022 është 289 vendime. Ndihmë juridike dytësore (pagesa avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore)	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore për periudhën 2023 është 348 vendime. Ndihmë juridike dytësore (pagesa	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore për periudhën 2024 është 391 vendime. Ndihmë juridike dytësore (pagesa avokatësh, ekspertësh dhe

³ Rastet e evdinetuara nuk përfshijnë rastet e trajtuara nëpërmjet **Platformës Juristi Online dhe Nr. i Gjelbër.**

⁴ Rastet e evdinetuara nuk përfshijnë rastet e trajtuara nëpërmjet **Platformës Juristi Online dhe Nr. i Gjelbër.**

		<i>avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore)</i> me vlerë totale prej 5,188,929 lekë.	me vlerë totale prej 9.895.440 lekë.	<i>avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore)</i> me vlerë totale prej 12.280.100 lekë.	<i>tarifa gjyqësore)</i> me vlerë totale prej 14.243.120 lekë.
--	--	---	--------------------------------------	--	--

13 PLANI I PUNËS SË DNJF, 2025

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë, dokumentat strategjikë në të cilat DNJF është e përfshirë si dhe rekomandimet e lëna nga KLSH gjatë ushtrimit të kontrollit me temë: “*Ndihma Juridike e Garantuar nga Shteti*”.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, është plani i gjashtë i miratuar që nga fillimi i funksionimit të DNJF. Ky dokument është kontribut dhe ka për objekt veprimtarinë e të 3 (tre) Drejtorive përbërëse të DNJF. Ky plan është një dokument pune i cili shërben si udhëheqës në realizimin e objektivave institucionale përmes përcatimit të masave dhe aktiviteteve konkrete.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, përmbledh detyrimet funksionale, përpilimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji “*Zbatimin e Sistemit Buxhetor në RSH*”, duke synuar zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare si dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, parashikon **11 objektiva të strukturuar** si vijon:

1. Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike parësore;
2. Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dytësore;
3. Monitorimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore;
4. Ndërveprimi me donatorët dhe institucionet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike falas në drejtim të krijimit të databazës elektronike, mbi rastet e ndihmës juridike parësore dhe platformës mbi ndihmën ligjore falas online;
5. Dhënia e kontributit të DNJF në kuadër të dokumentave strategjike dhe procesit të të integritimit evropian;
6. Informimi dhe promovimi mbi sistemin e ndihmës juridike;
7. Raportime mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
8. Menaxhimi dhe planifikimi financiar i sistemit të ndihmës juridike;
9. Rialokimi dhe detajimi i fondeve të buxhetit vjetor;
10. Mirëadministrimi i Burimeve Njerëzore në funksion të strukturës së re të DNJF-së, për vitin 2025 dhe Prokurimi i fondeve publike;
11. Hartimi i raporteve financiare, analiza financiare si dhe raportime në kuadër të granteve/projekteve në bashkëpunim me Organizatat Ndërkombëtare;

	mbështetjen e UNDP, pas përfundimit të marrëveshjes në Dhjetor 2024.	Fillimi i marrëdhënieve financiare për 6 punonjësit me trajnim të posaçëm të Qendrave Lezhë, Pogradec, Korçë, Dibër, Elbasan dhe Kukës.	Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse Ministria e Drejtësisë	
1.4	Miratimi i punonjësve shtesë me kontratë të përkohshme në QSHNJP Shkodër dhe Pukë me qëllim ndjekjen e procesit të regjistrimit të tokave bujqësore	Në kushtet kur Task-Forca “Për koordinimin e procesit të trajtimit të tokave bujqësore në përdorim, në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020”, ka kërkuar shtyrjen e afatit të VKM nr. 320/2023 deri në datën 31.05.2025	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse Ministria e Drejtësisë	Janar-Dhjetor 2025
1.5	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve QSHNJP nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve fillestare vazhduese.	Administrimi i nevojave për trajnime vazhduese të përcjella nga punonjësit e QSHNJP dhe përfshirja e tyre në programin e planifikimit të trajnimeve vazhduese. Shkresë DAP/ASPA me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim për miratimin e programit të planifikimit të trajnimeve vazhduese për vitin 2024, si dhe zhvillimin e trajnimeve, si detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 9 shkronja “g” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Shkresë Organizatave Ndërkombëtare Mbështetëse me lëndë: <i>Kërkesë për mbështetje për rritjen e kapaciteteve dhe aftësimin profesional të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</i> Zhvillimi i trajnimeve vazhduese nga ASPA/Organizatave Ndërkombëtare Mbështetëse në rast dakordësie të kërkeses për mbështetje.	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore. Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Janar-Dhjetor 2025
1.6	Hapja e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i	- Shkresë Ministrisë së Drejtësisë me qëllim dakordësinë mbi afatin e hapjes së thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar.	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Janar-Prill 2025

	Drejtësisë përfundimit projekteve proces. pas të në	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i Planit Vjetor të Financimit dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të MD/DNJF - Hapja e thirrjes për financim sipas përcaktimeve të VKM nr. 55/2019. - Marrja pjesë në komisionin e vlerësimit dhe ankimit për financimin e OJF-ve - Ndërmarrja e procedurave për lidhjen e kontratave me Organizatat e shpallura fituese 	Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse	
1.7	Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit	<p>Ndërveprimi aktiv mes DNJF dhe Klinikave të Ligjit me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnimit mbi ndihmën juridike për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Praktikave të punës për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Zhvillimit të aktiviteve të përbashkëta ndërgjegjësuere/informuese 	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Mars 2025
1.8	Administrimi i plotë i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore.	<ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi ndihmën juridike parësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike parësore - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike parësore (analizë që hartohet çdo muaj). 	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 2: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
2.1	Rishikimi i akteve nënligjore në fushën e ndihmës juridike dytësore me qëllim përmirësimin e procedurave dhe dhënien e shërbimit për qytetarët.	<ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i akteve nënligjore; - Miratimi dhe hyrja në fuqi e tyre 	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore	Janar-Mars 2025

2.2	Sigurimi shërbimit avokatëve i të	- Lidhja e kontratës me avokatët për vitin 2025 si dhe publikimi i listës	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore	Janar-Mars 2025
2.3	Administrimi i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore	- Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi numrin e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike dytësore për përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore; - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike dytësore (analizë që hartohet çdo muaj).	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar-Dhjetor 2025
2.4	Ndjekja e vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore	- Komunikimi me Dhomat Vendore të Avokatisë në kuadër të caktimit të avokatit që do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike dytësore; - Ankimimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga shpenzimet / tarifat gjyqësore referuar nenit 22 pika 9 e Ligjit 111/2017 “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë”.	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 3: MONITORIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE/DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
-----	---------------------------------	----------------------------------	-----------------------------	-----------------

3.1	Monitorimi i shërbimit ofruar Qendrat Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore nga e të Parësore	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve Kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar-Dhjetor 2025
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		Janar-Dhjetor 2025
3.2	Monitorimi i shërbimit ofruar Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit nga të	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Majr-Dhjetor 2025
		Kryerja e monitorimeve katër mujore për organizatat		Maj-Gusht 2024 Shtator-Dhjetor 2024
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		Maj-Gusht 2024 Shtator-Dhjetor 2024
3.3	Monitorimi i shërbimit ofruar Avokatët e ndihmës juridike dytësore nga e të	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve Kryerja e monitorimit fillestar për avokatët e rinj të ndihmës juridike dytësore Kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore Hartimi i raporteve të monitorimit/Vlerësimi i performancës Hartimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe përcjellja e rekomandimeve përkatëse	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar-Dhjetor 2025
3.4	Hartimi i raporteve përmbledhëse të monitorimit nga të	Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike parësore; Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike dytësore.	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar-Dhjetor 2025
3.5	Kryerja e pagesave ofruesit për e	Verifikimi i dokumentacionit sipas raportit të monitorimit Fatura tatimore	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2025

	shërbimit të ndihmës juridike			
--	-------------------------------	--	--	--

OBJEKTIVI 4: NDËRVEPRIMI ME DONATORËT DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
4.1	Ndërveprimi me UNDP në kuadër të projekteve të përbashkëta	Ndjekja e procedurës së krijimit dhe funksionimit të: Databazës elektronike Platformës mbi ndihmën ligjore falas online	Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Janar - Dhjetor 2025 <i>Në varësi të kohëzgjatjes së projekteve me donatorët</i>
4.2	Ndjekja e proceseve të punës me donatorë të ndryshëm si UNDP, OSCE, Agjencia Franceze për Zhvillim, JUSTAL etj.	- Evidentimi i nevojave për mbështetje; - Zhvillimi i takimeve në kuadër të bashkëpunimit; - Ndërmarrja e procedurave të bashkëpunimit në rast dakordësie	DNJF UNDP OSCE Agjencia Franceze për Zhvillim JUSTAL	Janar - Dhjetor 2025 <i>Në varësi të projekteve me donatorët</i>

OBJEKTIVI 5: DHËNIA E KONTRIBUTIT DHE RAPORTIMI I DNJF NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN/STRATEGJIVE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
5.1	Raportime në kuadër të procesit të Integrimit Evropian dhe Konventave Ndërkombëtare/Strategjive	- Angazhim i DNJF-së, në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP). - Angazhim i DNJF-së, në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) - Angazhim i DNJF-së, në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM) - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të angazhimit në Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP)	Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Janar - Dhjetor 2025

		<ul style="list-style-type: none"> - Angazhimin i DNJF-së, në kuadër të procesit të Integritimit Europian dhe Raportimeve Ndërkombëtare - Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paranëtarësimit IPA. - Kontributi i DNJF-së, për CEPEJ “<i>Dashboard Western Balkans</i>”; - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të raportimit të Kapitullit 23. - Kontribut në kuadër të monitorimit e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave; - Kontribut i DNJF-së, për Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve - Kontribut në Strategjinë ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit për periudhën 2024-2030; - Kontribut sa i përket Nënkomitetit Bashkimi Evropian–Shqipëri “<i>Drejtësia, Liria dhe Siguria</i>”. - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të raportimit mbi kontributin e parë final për kapitullin 23 dhe Institucionet demokratike; - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të raportimit mbi draftin e Pozicionit Negociues, në kuadër të procesit të hartimit të udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës; - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të raportimit për Konventën e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (Konventa e Stambollit); - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të raportimit mbi draftin e Pozicionit Negociues, të Kapitullit 24, në kuadër të Bashkëpunimit Gjyqësor për çështje civile dhe penale; 		
--	--	--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të Agjendës 2030 dhe objektivave të zhvillimit të qendrurshëm; - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK); - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të SASPAC për raportimin e projekteve me financim të huaj. 		
--	--	---	--	--

OBJEKTIVI 6: PROMOVIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
6.1	Përgatitja dhe ndjekja e publikimeve të DNJF në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Facebook, instagram	Ndjekje e procedurave të nevojshme me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.	DNJF	Janar-Dhjetor 2025
6.2	Përditësimi i faqes ëeb të DNJF	Përditësimi dhe publikimi i të dhënave më të fundit sipas rubrikave të mirëpërcaktuara.	DNJF	Janar-Dhjetor 2025
6.3	Zhvillimi i takimeve promovuese/sensi bilizuese/ edukimit ligjor të publikut	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i një analize me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike ku të përcaktohen komponentët ku duhet të zbatohet Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore në konceptimin e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve; - Hartimi i Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2025, duke u bazuar në komponentët dhe gjetjet e analizës - Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe sesioneve të edukimit ligjor 	DNJF Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore	Janar 2025 Janar – Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 7: RAPORTIME MBI SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
7.1	Përgatitja e raportimeve drejtuar Ministrit të Drejtësisë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti	- Hartimi i raportimeve mujore; 3 mujore; 6 mujore dhe vjetore drejtuar Ministrit të Drejtësisë; - Hartimi i raportimeve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë në varësi të kërkesave	DNJF	Janar-Dhjetor 2025
7.2	Trajtimi i shkresave nga institucione të ndryshme në kuadër të raportimit mbi ecurinë dhe progresin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti	Dhënia e informacionit mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti lidhur me kërkesat për informacion.	DNJF	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 8: MENAXHIMI DHE PLANIFIKIMI FINANCIAR I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
8.1	Vlerësimi i kostove dhe planifikimi i shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike	Ndjekja, analizimi dhe planifikimi i shpenzimeve financiare mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.	Dr. Financave	Janar 2025
8.2	Menaxhimi i fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike	Menaaxhimi i fondeve buxhetore të DNJF dhe hartimi i raportimeve financiare	Dr. Financave	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 9 : RIALOKIMI DHE DETAJIMIN I FONDEVE TË BUXHETIT VJETOR RAPORTIME

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
9.1	Detajimi i fondeve të Buxhetit për vitin 2024	Rialokimi i fondeve të papërdorura me financim nga donatorët sipas strukturave buxhetore si dhe sipas nevojave të institucionit Pasqyrimi në regjistrin e parashikimit të prokurimeve	Drejtorja e Financës Komisioni i Prokurimit	Janar 2024

		publike dhe shpallja në faqen zyrtare të APP dhe Institucionit të ndryshimeve Realizimi i likujdimit të detyrimeve të prapambetura me prioritet.	Drejtoria e Financës	Janar 2024 Janar-Dhjetor 2024
--	--	---	----------------------	--------------------------------------

HARTIMI I PAGESAVE TË PUNONJËSVE TË DNJF NGA STRUKTURAT E BUXHETIT TË SHETIT DHE NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
9.2	Hartimi i dokumentacionit financiar, për pagat sigurimet dhe shpenzimet	Hartimi i pagesave të pagave të punonjësve të NDJF si dhe punonjësit e qëndrave të sponsorizuar nga OJF Hartimi i Urdhër Shpenzimeve për shpenzimet financiare të artikujve 600 dhe 601 Deklarimi i sigurimeve shoqërore shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat Pasqyrimi në sistemin HRMIS të pagave të punonjësve Hartimi i listëprezencës së punonjësve	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2025
9.3	Urdhër Pagesat	Gjenerimi nga sistemi HRMIS i Urdhër Shpenzimeve Transfertat bankare sipas Bankave të nivelit të dytë Pasqyrimi i shtesave, ndalesave apo cdo vendim gjyqësor Sistemi AFMIS, paraqitja e dokumentacionit justifikues të shpenzimit dhe ngarkimi në sistem	Drejtoria e Financës	Janar - Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 10: MIRËADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE REKRUTIMI I PUNONJËSVE SIPAS STRUKTURËS SË RE TË DNJF TË MIRATUAR PËR VITIN 2025

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
10.1	Miratimi i numrit të Punonjësve për vitin 2025		Ministria e Drejtësisë	Janar 2025
10.2	Evidentimi i nevojave për kualifikimin e punonjësve	Evidentimi i kualifikimeve të punonjësve	Drejtoria e Financës ASP	Janar 2025

		Hartimi i planit vjetor të zhvillimit profesional të BNJ		
10.3	Vendet vakante	Evidentimi dhe raportimi i vendeve vakante në zbatim të strukturës së miratuar për institucionin Shpallja e vendeve vakante ne Sitemin HRMIS për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil Percaktimi i përshkrimit të punës dhe përcaktimi i kriterëve për kualifikim në procedurën e rekrutimit të punonjësve Shpallja në faqen Zyrtare të DNJF për vendet vakante, Ngritja e Grupit të punës për pranimin ose skualifikimin e kandidatëve	DAP Drejtoria e Financës Burimet Njerëzore	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 11: HARTIMI I RAPORTEVE FINANCIARE DHE ANALIZA E BUXHETIT

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.1	Pasqyrat financiare për vitin 2024	Plotësimi i pasqyrave financiare për vitin 2024, sipas formatit standart të miratuar nga Ministria e Financës	Drejtoria e Financës	Mars 2025
11.2	Inventarët fizikë dhe kontabël	Kryerja e inventarëve fizik dhe kontabël për aktivet e institucionit	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2025
11.3	Amortizimi i pajisjeve	Amortizimi i pajisjeve objekt inventari të DNJF-së Pasqyrimi i vlerave në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor paraardhës.	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2025

HARTIMI I REGJISTRIT TE RISKUT, FORMULARET E VETËVLERËSIMIT SI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.4	Hartimi i regjistrit të riskut	Ngritja e grupit të punës për hartimin e regjistrit të riskut	Grupi i punës Drejtoria e Financës	Janar 2025

11.5	Hartimi i formularit të vetëvlerësimit për institucionin	Hartimi i formualrit të vetëvlerësimit për periudhën Janar-Dhjetor dhe përcaktimi i performancës së institucionit	Drejtoria e Financës Grupi i punës	Janar 2025
------	---	---	---------------------------------------	---------------

PALAIS DE JUSTICE

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS



ADRESA: RR. "JORDAN MISJA", GODINA NR.3, TIRANË

